

Në bazë të nenit 167 të Ligjit mbi bazat e sistemit të administratës shtetërore dhe mbi Këshillin Ekzekutiv Federativ dhe organet federative të administratës, të nenit 6 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të jashtëzakonshme ("Gazeta zyrtare e RSS", të Serbisë", nr. 40/90) dhe të nenit 33 të Vendimit mbi organet komunale të administratës të Komunës së Prishtinës, sekretari i Sekretariatit për veprimtari shoqërore të Komunës së Prishtinës, në procedurën disiplinore për shkak të shkeljes së rëndë të obligimeve të punës, nxjerr

A K T V E N D I M

I. ZIJADIN GASHIT, punëtor i Sekretariatit për veprimtari shoqëror të Komunës së Prishtinës, në punët dhe detyrat e punës të inspektorit të arsimit, për shkak të shkeljes së rëndë të obligimeve të punës nga neni 8 i Ligjit mbi marrëdhëniet e punës në rrethanat e veçanta ("Gazeta zyrtare e RSS", nr. 40/90), i shqiptohet masa disiplinore për këtë shkelje me NDËRPRERJE të marrëdhënies së punës në Sekretariajin për veprimtari shoqëror të Komunës së Prishtinës, prej 1 marsit të vitit 1991.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 6 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të veçanta ("Gazeta zyrtare e RSS", nr. 40/90), sekretari i Sekretariatit për veprimtari shoqëror të Komunës së Prishtinës, kompetent për vendosje përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të punëtorëve dhe për shqiptimin e kësaj mase disiplinore të përcaktuar me Ligj, hap procedurën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këtë Sekretariat ndaj Zijadin Gashit, punëtorit të këtij Sekretariati në punët dhe detyrat e punës së inspektorit të arsimit, për këto shkaqe:

1.- Si inspektor i arsimit, Zijadin Gashi, nuk e zbatojë vendimin e Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Serbisë si dhe planin dhe programin mësimor të Republikës së Serbisë, por i zbatojë planet dhe programet mësimore si dhe vendimet e Pleqësisë së Arsimit të KSA të Kosovës në gjuhën shqipe dhe lidhur me këto ka dhënë shpjegime personale dhe i ka botuar në Gazetën "Shkëndija" ku ka sugjeruar që plan-programet mësimore të Republikës së Serbisë të mospranohen në territorin e Kosovës dhe Metohisë,

2. Se ka rrefuzuar kryerjen e urdhërave të sekretarit të Sekretariatit për veprimtari shoqëror të Komunës së Prishtinës në pikëpamje të kryerjes së detyrave të përditshme të punës e krahas këtyre edhe urdhërin që të paraqes raport me shkrim për punën e vet si inspektor

arsimor për vitin 1990, e që ka qenë i detyruar ta bëjë në përpunje me dispozitat e rregullore mbi organizimin dhe punët e këtij Sekretariati, me qëllim të përpilimit të raportit të tërësishëm mbi punën e Sekretariatit, të cilin do ta shqyrtonte Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës së Prishtinës e më vonë edhe Kuvendi i Komunës së Prishtinës kështu që raporti mbi punën e këtij sekretariati për shkak të qëndrimit të këtyre të punëtorit të përmendur mbeti i paplotësuar dhe si i tillë i është dërguar Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

3.- Zijadin Gashi, si inspektor i arsimit, pas asaj që refuzoi t'i kryejë detyrat e punës nga fushëveprimi i vet i punës, rrefuzoi edhe çdo bashkëpunim me eprorin e organit, përkatësisht me sekretarin e Sekretariatit për veprimtari shoqërore të Komunës së Prishtinës, nga se në këtë detyrë e ka caktuar Kuvendii Republiks së Serbisë me Vendim të datës 28.12.1990, e se këtë vendim ai nuk e njeh ashtu siç nuk i njeh edhe dispozitat tjera që i nxjerrë Republika e Serbisë.

Me qëndrimin e këtyre të Zijadin Gashit, si inspektor i arsimit, ndaj detyrave dhe punëve të këtij vendi të punës, si dhe me raportin ndaj eprorit të organit, shkaktojë shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 8 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të veçanta ("Gazeta zyrtare e RSS", nr. 40/90), andaj eprori i organit në përputhje me nenin 6 të Ligjit të përemundur ia shqiptoi masën disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi puntori ka të drejtë të paraqes kundërshtim në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Kundërshtimi paraqitet përmes këtij Sekretariati.

SEKRETARIATI PËR VEPRIMTARI SHOQËRORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Numër: 03-116- 4 më 28 shkurt 1991



SEKRETARI I SEKRETARIATIT,

Përlinçeviq Cedomir

Cedomir Perleci